



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E INOVACIONIT DHE
NDËRMARRËSISË**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Erëmira Bytyqi Pllana (Udhëheqës ekipi) dhe Mazlumsha Sejfadini (Anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	30
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	33

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 05.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MIN.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë kapitale jofinanciare të shpalosura në PFV në vlerë 221,592€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël të ministrisë, ndërsa pasuritë jokapitale ishin nënvlerësuar për vlerën prej 29,255€, pasi ato nuk ishin shpalosur në PFV dhe as nuk ishin regjistruar në ndonjë regjistër të ministrisë.

Më gjerësisht, shih kapitullin 2.1 të raportit.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të ministrisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet lidhur me pasuritë kapitale dhe jokapitale, në pasqyrat financiare vjetore, nuk ishin paraqitur në mënyrë të drejtë, përkatësisht nuk përputhen me regjistrat e pasurive të ministrisë për shkak të çështjeve të identifikuara si në vijim:

- MIN, kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Ferizajt, për ndërtimin dhe pajisjen e Qendrës Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me ç'rast MIN do të financonte tërësisht realizimin e projektit, i cili pas realizimit do të kalonte në pronësi të

komunës. Kosto e projektit ishte 236,568€, ndërsa deri në fund të vitit 2018, ministria kishte realizuar pagesat në vlerë 221,592€, pasi projekti nuk kishte arritur të realizohej në tërësi. Pagesat e realizuara, ministria nuk i kishte regjistruar si pasuri, përkatësisht si investime në vijim në SIMFK, edhe pse ishin të shpalosura në PFV. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së njohurive të personelit të ministrisë, për të bërë regjistrimin e pasurive kapitale në SIMFK.

- Neni 19.3.2 i PFV-ve - Pasuritë jo financiare jokapitale ishin të nënvlerësuara për 29,255€, sepse ato nuk ishin shpalosur në PFV si dhe nuk ishin regjistruar në e-pasuri e as në ndonjë regjistër të brendshëm. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së zyrtarit të pasurisë brenda ministrisë dhe mos sigurimit të çasjes në sistem për regjistrimin e tyre, edhe pse ministria gjatë vitit kishte bërë përpjekje dhe kërkesa drejtuar institucioneve përkatëse për sigurimin e çasjes në sistemin e-pasuria.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MIN, kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore;
- Raportet financiare tre-mujore, raportet operative;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Draft PFV-të e ministrisë ishin keq deklaruar me vlera materiale nëpër zërat kryesor, por pas sugjerimeve tona ato ishin korrigjuar me 22.02.2019.

Lidhur me PFV-ve, përveç çështjes së ngritur tek Theksimi i Çështjes, nuk kemi çështje për të ngritur.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV DHE ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet si vijon:

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektin e Qendrës Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, janë regjistruar në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit, dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia.

Gjithashtu, duhet të siguroj se janë marrë veprime të menjëhershme për sigurimin e çasjes në e-pasuri dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për pasuri, në mënyrë që të gjitha pasuritë jokapitale të ministrisë, regjistrohen dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe si të tilla të prezantohen drejtë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare të MIN, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Duke qenë se MIN është institucion i ri, i themeluar në tetor të vitit 2017 dhe është në konsolidim e sipër, kontrollet nuk kanë arritur të zbatohen me konsistencë dhe atë kryesisht në fushat si: menaxhimi jo i mirë i avanceve, realizimi i pagesave ndaj zyrtarëve pa bazë ligjore, mangësitë e paraqitura gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve dhe mbikëqyrja jo e mirë e projekteve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi dhe realizimi i buxhetit, kontrollet në fushën e pagesave, plotësimi i pozitave me staf të rregullt si dhe menaxhimi i duhur i pasurive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,817,043	5,271,768	5,116,773	5,038
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,817,043	5,271,768	5,116,773	5,038

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,545,275€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë mbi deklarimin e kursimeve/mjeteve të pashpenzuara në fund të vitit, në të gjitha kategoritë, me theks të veçantë në kategorinë e investimeve kapitale dhe subvencioneve e transfereve.

Në vitin 2018, ministria ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 5,116,773€.

Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,817,043	5,271,768	5,116,773	5,038
Pagat dhe Mëditjet	259,043	208,863	208,863	
Mallrat dhe Shërbimet	385,000	385,000	260,443	5,038
Shërbimet komunale	23,000	7,981	1,544	
Subvencionet dhe Transferet	7,150,000	4,433,331	4,424,330	
Investimet Kapitale	2,000,000	236,593	221,593	

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 50,179€ në krahasim me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim është bërë në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 04/70 të datës 19.10.2018 në vlerë 59,049€, dhe rritjes në vlerë 8,869€ sipas vendimit të Qeverisë nr. 07/80 të datës 18.12.2018. Realizimi i buxhetit për paga, krahasuar me buxhetin final ishte 100%.
- Buxheti për mallra dhe shërbime nuk kishte pësuar ndryshim. Megjithatë, realizimi në këtë kategori ishte 68%, ndërkaq buxheti për komunalitet ishte zvogëluar për 15,020€ sipas

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

vendimit të Qeverisë nr. 07/80 të datës 18.12.2018. Realizimi në këtë kategori ishte vetëm 19%. Përkundër mos realizimit të mjaftueshëm të buxhetit, obligimet në këto kategori ishin 8,993€.

- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 2,716,669€, sipas vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje, transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive. Zvogëlimi i buxhetit ishte si rezultat i anulimit të thirrjes për financimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM).
- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,763,407€, sipas vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje, transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive.

Çështja A2² - Planifikimi dhe realizimi jo i mirë i buxhetit

Gjetja

MIN, kishte treguar performancë jo të mirë sa i përket realizimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale. Bazuar në buxhetin fillestar, ministria kishte planifikuar që për vitin 2018, të realizonte pesë (5) projekte kapitale, por në fund të vitit, në të gjitha projektet, shumica e fondeve ishin reduktuar, për shkak të mos realizimit të projekteve. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së personelit për inicim të procedurave.

MIN, kishte arritur të shpenzoj buxhetin për mallra dhe shërbime në përqindje mjaft të ultë, me vetëm 68%, si dhe atë për komunalitet me vetëm 19%. Kjo kishte ndodhur për shkak të një planifikimi dhe menaxhimi jo të mirë të buxhetit në këto kategori.

Rreziku

Mos efikasiteti në shpenzimin e buxhetit në kategoritë përkatëse ndikon në mos arritjen e objektivave të ministrisë dhe reduktimin e planeve buxhetore në vitet e ardhshme.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet nuk kanë arritur të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2018, ishte 208,863€, të cilat ishin shpenzuar në tërësi.

Çështja A3 Plotësimi i pozitave të rregullta me marrëveshje për shërbime të veçanta

Gjetja Bazuar në Rregulloren (QRK) nr. 23/2017³, është përcaktuar struktura organizative e ministrisë, përfshirë numrin e të punësuarve për secilin departament/divizion.

Në nëntë raste, kemi vërejtur se MIN kishte rekrutuar punonjës me “Marrëveshje për Shërbime të Veçanta “me afat tre deri në gjashtë muaj, në pozita të cilat ishin paraparë përmes rregullores të rekrutohen si pozita të rregullta, prej të cilëve katër zyrtarë brenda departamentit të inovacionit, tre brenda departamentit të ndërmarrësisë, si dhe dy në departamentin për financa dhe shërbime të përgjithshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të nevojës për funksionalizim të ministrisë, duke qenë se rekrutimi përmes procedurave të rregullta kërkon kohë më të gjatë për t’u realizuar, ndërsa angazhimi i punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta, kishte mundësuar plotësimin e pozitave të lira përmes një procedure të thjeshtëzuar të rekrutimit.

Rreziku Plotësimi i pozitave të rregullta me staf të përkohshëm, rrezikon angazhimin e stafit jo adekuat në pozitat përkatëse dhe mund të rezultojë me performancë të dobët në kryerjen e detyrave. Kjo më pas mund të ketë efekt negativ në realizimin e objektivave në nivel të ministrisë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për plotësimin e pozitave të lira me staf të rregullt dhe jo përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa këto të fundit të aplikohen vetëm për punë/shërbime të cilat nuk janë të parapara si pozita të rregullta pune.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, si dhe komunalit në vitin 2018 ishte 392,981€. Prej tyre, ishin shpenzuar 261,987€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, shpenzime të reprezentacionit, qiraja për automjete, shërbime kontraktuese, blerja e pajisjeve të IT-së, inventarit etj.

³ Rregullore (QRK) nr. 23/2017, për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, miratuar në janar 2018.

Çështja A4 - Vonesat në mbylljen e avanceve dhe menaxhimi jo i mirë

Gjetja Sipas Procedurës për regjistrimin në SIMFK të avanceve për para të imët dhe avanceve për udhëtime zyrtare, procedimi i avanceve për udhëtim zyrtar, përcakton se përfituesi i avancit për udhëtim zyrtar obligohet që të bëjë arsyetimin e avancit, jo më larg se dy (2) javë nga kthimi i udhëtimit zyrtar. Tek zyrtari i caktuar për mbajtjen e avanceve dorëzohet i tërë dokumentacioni /faturat si dhe mjetet tepricë nëse ka.

Nga testimi i avanseve kemi gjetur parregullsitë si në vijim:

- Në 13 raste, avancet për udhëtime zyrtare në vlerë 13,367€, ishin mbyllur me vonesë deri në 10 muaj dhe si pasojë e vonesave, mjetet tepricë në vlerë 1,779€ nuk ishin deponuar me kohë në llogari të ministrisë.
- Në avancin e tërhequr në vlerë 3,125€ për udhëtimin zyrtar në SHBA, ishin realizuar tri udhëtime zyrtare të njëpasnjëshme, pa u bërë mbyllja e avancit nga udhëtimi paraprak. Mjetet e pashpenzuara nga udhëtimi i parë, ishin bartur tek dy zyrtarët tjerë për tu realizuar dy udhëtimet vijuese, në Belgjikë dhe Bosnje dhe Hercegovinë.

Këto mangësi kishin ndodhur për shkak se zyrtari i avanceve nuk i kishte deponuar mjetet me kohë në llogarinë bankare, si dhe në disa raste, kishte vonesa në arsyetimin e faturave nga shfrytëzuesit e avancit.

Rreziku Vonesat në deponimin e tepricave të avancit në llogari dhe mos arsyetimin e faturave nga shfrytëzuesit e avancit, rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve tepricë dhe shfrytëzimin e atyre mjeteve për qëllime tjera nga ato zyrtare.

Rekomandimi A4 Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrole efektive tek menaxhimi i avanceve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që zyrtarët të jenë përgjegjës për arsyetimin e mjeteve me kohë, dhe kthimi i mjeteve të pashpenzuara në llogari të bëhet brenda afatit ligjor.

Çështja A5 Blerja e pajisjes teknologjike me mjetet e avancit për udhëtim zyrtar**Gjetja**

Sipas Procedurës për regjistrimin në SIMFK të avanceve për para të imët dhe avanceve për udhëtime zyrtare, Aneksi 6, Llogaritja e shpenzimeve për udhëtime zyrtare, pika B, janë të përcaktuara shpenzimet që mund të mbulohen nga mjetet e avancit si: akomodimi, ushqimi, mëditja dhe shpenzime tjera/para xhepi.

Me avancin e tërhequr në vlerë 1,814€, ishte blerë një llaptop në vlerë 1,064€ jashtë vendit. Pas realizimit të udhëtimit këto shpenzime ishin mbyllur në kodin ekonomik "Pajisje tjera nën 1,000€", e që është kundërshtim me procedurat për regjistrimin e avanceve në SIMFK.

Sipas shpjegimeve të ministrisë kjo kishte ndodhur për shkak se ministri gjatë vizitës zyrtare në ShBA kishte shpreh nevojën për një llaptop.

Rreziku

Shfrytëzimi i mjeteve nga avanci për udhëtime zyrtare për blerje të pajisjeve, rrit rrezikun e përdorimit të këtyre mjeteve për qëllime tjera, nga ato për të cilat është destinuar avanci për udhëtime zyrtare.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se shfrytëzimi i avancit për udhëtime zyrtare për blerje të pa autorizuar, nuk do të përsëritet në asnjë rast tjetër.

Çështja A6 Kompensimi i zyrtarëve të MPJ-së për shërbimet e ofruara ndaj MIN

Gjetja Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit mes MIN dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), neni 2, personeli i MPJ-së sipas nevojës mbështet MIN në lëmin e financave dhe shërbimeve të përgjithshme dhe prokurimit. Në këtë marrëveshje nuk është përcaktuar ndonjë formë e kompensimit.

UD Sekretari i Përgjithshëm në MIN gjatë muajit dhjetor 2017, i cili njëkohësisht ishte Sekretar i Përgjithshëm i MPJ-së, kishte lidhur kontratë me zyrtarë të caktuar nga MPJ, për kompensimin e tyre lidhur me kryerjen e shërbimeve ndaj MIN, në shkallën prej 50% të pagës për çdo muaj bazuar në nenin 3 të marrëveshjes së mirëkuptimit, i cili nen nuk ekzistonte fare në marrëveshje. Vlera e këtyre pagesave ishte 2,067€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së personelit dhe kontrolleve të duhura në fillimet e funksionimit të ministrisë.

Rreziku Pagesat e realizuara ndaj zyrtarëve të MPJ-së, nuk janë të mbështetura me bazë ligjore dhe si të tilla, rrezikojnë dëmtimin e buxhetit të MIN për vlerën e shpenzuar.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të rishikoj rastin e këtyre pagesave dhe të konfirmoj nëse pagesat janë kryer për punët e kryera jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, paratë t'i kthehen buxhetit të ministrisë.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 4,433,331€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 4,424,330€. Ato kanë të bëjnë me mbështetjen financiare ndaj OJQ-ve për promovimin e zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe financimin e bizneseve fillestare "Start Up" në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Pesë mostra të përzgjedhura nga popullacioni i subvencione dhe transfere në vlerë totale prej 549,675€, nuk janë audituar nga ne për shkak se ishin në procedurë hetimore nga organet kompetente. Këto mostra ne i kemi zëvendësuar me pesë mostra tjera, dhe gjetjet tona në kë fushë janë përshkruar si më poshtë.

Çështja A7 - Dobësi gjatë procesit të përzgjedhjes për financimin e OJQ-ve

Gjetja

Bazuar në udhëzuesin për aplikant për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në promovimin dhe mbështetjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe thirrjes publike për aplikim, MIN iu ka bërë thirrje të gjitha OJQ-ve, programi i punës dhe projektet e të cilave janë të fokusuar në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Aktivitetet që nuk janë të pranueshme për financim, ndër tjera, ishin edhe trajnimet që nuk përkrahin rritjen e aftësive në inovacion dhe teknologji.

Ndër kriteret e vendosura për përzgjedhje, aplikuesi duhej të:

- Dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare;
- Në rast të angazhimit të ekspertëve të jashtëm, të dorëzojnë deklaratën e pranimi nga ana e tyre se do të angazhohen në projekt për pozitën e caktuar;
- Për OJQ-të të cilat aplikojnë në nivelin 200,000€, të sigurohen tri (3) referenca për projekte të suksesshme.

Në tri, nga gjashtë raste të testuara, OJQ⁴-të përkatëse nuk kishin plotësuar kriteret e thirrjes, pasi programi i punës së tyre nuk ishte i fokusuar në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Po ashtu, projektet për të cilat kishin aplikuar, nuk ishin në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e caktuara për financim të vendosura në thirrje. Fushë veprimtaritë dhe projektet kishin të bënin me edukimin shëndetësor dhe ngritja e nivelit profesional në fushën e shëndetësisë, sigurimi i shërbimeve humanitare, trajnimet lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe dhënien e këshillave ndaj bletarëve.

Në tri raste, për OJQ-të⁵ e përzgjedhura për financim, nuk ishin siguruar dëshmitë mbi CV-të dhe deklaratat për pjesëmarrje të personelit/ekspertëve të cilët aplikuesi ka deklaruar se do t'i angazhoj.

Në një rast, OJQ⁶ nuk kishte siguruar tri referenca për projekte të suksesshme.

Megjithatë, këto OJQ ishin përzgjedhur si përfitues nga komisioni i vlerësimit dhe vlera totale e financimit të tyre nga MIN ishte 244,840€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i pa kujdesisë së komisionit të vlerësimit, për t'i vlerësuar aplikacionet e OJQ-ve në pajtim me kërkesat e udhëzuesit.

⁴ Kryqi i Kuq i Kosovës (200,000€); Shoqata e Bletarëve AMA (14,900€); €, Human Care (14,940€)

⁵Egnatia (vlera e financimit 15,000), Shoqata e Bletarëve AMA (14,900€), Kryqi i Kuq i Kosovës (200,000€)

⁶ Kryqi i Kuq i Kosovës vlera e financimit 200,000€

Rreziku Pa kujdesitë gjatë vlerësimit të aplikacioneve për OJQ-të nga komisioni i vlerësimit, kanë rezultuar me ndarjen e subvencioneve jo në pajtim me kriteret e përcaktuara dhe objektivat e ministrisë. Kjo rritë rrezikun që fondet e destinuar për mbështetje të inovacionit dhe ndërmarrësisë, të përdoren për qëllime tjera dhe të mos arrijnë vlerën për para dhe objektivat e ministrisë.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të rritë masat e përgjegjësisë ndaj komisionit të vlerësimit të OJQ-ve, për të siguruar se vlerësimi i aplikacioneve bëhet me përgjegjësi dhe objektivizëm sipas kriterëve të përcaktuara dhe kërkesave tjera ligjore.

Çështja A8 Ndarja e mjeteve për bizneset Start Up jo në pajtim me udhëzimin

Gjetja Bazuar në Udhëzimin Administrativ 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria subvencione dhe transfere (më tutje UA 01/2018), Start-Up përkufizohen si biznese fillestare të cilat përfshijnë ide inovative biznesore që kalojnë nga faza e inkubimit deri në aprovim si ide me potencial për efekte ekonomike.

MIN, gjatë vitit 2018 kishte bërë një thirrje publike për Start Up, dy thirrje për OJQ si dhe thirrjen për NVM, megjithatë thirrja e parë për OJQ dhe thirrja për NVM ishin anuluar.

Nga mostrat e testuara për përfituesit nga thirrja për Start Up, kemi vërejtur se në tri raste, përfitues ishin bizneset ekzistuese aktive dy prej të cilave që nga vitet 2004 dhe 2005. Dy nga këta përfitues ishin përzgjedhur nga thirrja për Start Up edhe pse nuk i plotësonin kriteret sepse aplikacionet e tyre kishin të bënin me thirrjen për subvencionim të NVM dhe OJQ.

Vlera totale e këtyre subvencioneve ishte 28,747€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i pakujdesisë së komisionit vlerësues, gjatë procesit të vlerësimit.

Rreziku Ministria aplikon kontrole të dobëta në fushën e subvencioneve. Përkrahja financiare e bizneseve ekzistuese të cilat ushtrojnë veprimtarinë prej më shumë se një vit e deri në 15 vite, si përfitues të fondit Start Up, është në kundërshtim me kriteret dhe paraqet keqmenaxhim të fondeve, me efekt në mos arritjen e qëllimit për të cilin fondet janë planifikuar.

Rekomandimi A8 Ministri, si edhe në rekomandimin më lart, duhet të vendos kontrole rigoroze në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për financim të bizneseve Start Up, në mënyrë që përzgjedhja e përfituesve bëhet bazuar në objektivat e thirrjes për financim, në përputhje me udhëzimin administrativ përkatës të ministrisë.

Çështja A9 Dobësi tjera gjatë procesit të vlerësimit të aplikacioneve për Start Up

Gjetja

Bazuar në UA 01/2018 dhe thirrjen për aplikim, për t'u konsideruar si aplikacion i kompletuar dhe për të plotësuar kriteret e vlerësimit, aplikuesi duhet:

- Të siguroj deklaratë që nuk ka pranuar mjete për të njëjtat aktivitete;
- Si shpenzime të papranueshme për financim, konsiderohen prokurimi i automjeteve komerciale; si dhe
- Të dëshmohet se mjetet e ndara të ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës.

Në katër raste kemi vërejtur se deklarata që aplikuesi nuk ka pranuar mjete për të njëjtat aktivitete është ofruar pas shpalljes së rezultateve preliminare, ndërsa në tri raste kjo deklaratë mungon, ndonëse ky dokument ka qenë obligativ të sigurohet gjatë aplikimit.

Në një aplikacion të përzgjedhur si përfitues për Start Up, në aktivitetet e propozuara në buxhet, ishte blerja e një automjeti komercial (kamionit) në vlerë 8,000€, edhe pse ky shpenzim ishte i papranueshëm për financim.

Në tri raste, ku kishin aplikuar bizneset ekzistuese, ishin paraparë vetëm blerje të pajisjeve, dhe jo mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës.

Këto mangësi, kishin ndodhur si pasojë e neglizhencës gjatë punës së kryer nga komisioni i vlerësimit.

Rreziku

Edhe në rastet më sipër vërehet mungesë serioze e kontrolleve dhe mos përfillje e kriteve. Mangësitë e identifikuara më sipër, kanë rezultuar me ndarjen e fondeve jo në pajtim me kriteret, qëllimet dhe objektivat, dhe kjo rritë rrezikun për dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A9

Ministri, duhet të merr masa të menjëhershme dhe të ndërpres praktikën e tilla, duke vendosur mekanizma efektiv të mbikëqyrjes ndaj procesit të vlerësimit për mbështetje financiare ndaj Start Up-ve dhe të siguroj se komisionet e vlerësimit kryejnë punën me përgjegjësi të lartë. Në rastet ku financimi ka qenë shpenzim i papranueshëm, sikurse blerja e automjetit komercial, mjetet e përfituara të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja A10 Mos raportimi i përfituesve nga subvencionet dhe transferet

Gjetja Bazuar në marrëveshjet e lidhura mes MIN dhe përfituesve të subvencioneve nga OJQ-të dhe bizneset (Start Up), përfituesit duhet të ofrojnë çdo tre-mujor një raport narrativ dhe financiar mbi zbatimin e aktiviteteve.

Nga gjashtë raste të testuara për OJQ, kemi vërejtur se:

OJQ Egnatia (vlera e subvencionuar 15,000€), nuk kishte raportuar për shpenzimet e realizuara në periudhën tre-mujore;

OJQ Nëna Terezë, e cila ishte subvencionuar në vlerë 198,560€, në raportin e shpenzimeve për vlerën 17,163€ kishte arsyetuar vetëm pagat e personelit të angazhuar dhe shpenzimet operative (rrymë, naftë, internet), ndërsa për shpenzimet e aktiviteteve lidhur me projektin, përkatësisht ngritjen e kapaciteteve përmes pjesëmarrjes së 100 personave në Qendrat për Aftësim Profesional, në vlerë 6,328€, nuk ka siguruar fatura/dëshmi për arsyetimin e mjeteve të shpenzuara.

Nga 10 raste të testuara për përfituesit e mbështetjes nga Start Up, kemi vërejtur se tre prej tyre nuk kishin sjellur të gjitha dëshmitë/faturat lidhur me shpenzimin e mjeteve, apo në përputhje me aktivitetet e planifikuara në propozim buxhetet.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së përgjegjësisë nga përfituesit dhe monitorimit jo të mjaftueshëm nga komisionet për monitorim.

Rreziku Mos raportimi i mjeteve të shpenzuara, mungesa e faturave dhe sigurimi i faturave që nuk dëshmojnë se mjetet janë shpenzuar në përputhje me qëllimin e dhënë, mund të rezultojë me devijime nga qëllimet e përfitimit të mjeteve dhe keqpërdorime.

Rekomandimi A10 Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Start Up-et, për sigurimin e dëshmimeve të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 236,593€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 221,593€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe pajisjen e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në komunën e Ferizajt.

Çështja A11 Mos respektimi i marrëveshjes mes MIN dhe Komunës lidhur me projektin dhe pagesa për punë të papërfunduara

Gjetja Bazuar në Marrëveshjen mes MIN dhe Komunës së Ferizajt për financimin e projektit “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj” në vlerë 373,231€, ndër të tjera theksohet se:

- MIN cakton një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës,
- Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës i cili me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
- Komuna obligohet që të njoftoj MIN për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dyjavor deri në përfundim të projektit.

Të dy palët nuk ishin respektuar këto pika të marrëveshjes, me ç`rast ministria nuk kishte caktuar zyrtarin për mbikëqyrje të realizimit të projektit dhe as komuna nuk kishte njoftuar ministrinë për rrjedhat e realizimit të projektit.

Në pagesën e testuar në vlerë 134,645€, të kontratës “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, renovimi i Qendrës së Kulturës “në vlerë 149,620€, ne kemi bërë ekzaminimin fizik, me ç`rast kemi identifikuar se këto pozicione të cilat ishin lëshuar në dokumentacionin financiar për pagesë si të përfunduara nga operatori ekonomik dhe të verifikuara nga menaxheri i projektit i komunës, nuk ishin kryer. Pozicionet e paguara, por të pa përfunduara, ishin:

Punët e meremetimit:

Pozicioni nr.8. Krijimi i rampave sipas standardeve, në korridorin kryesore me disnivel prej 70cm, në dy nivele, me vlerë 840€;

Pozicioni nr. 18. Furnizimi dhe montimi i dyerve të reja nga materiali i njëjtë me ato ekzistuese me dimensione 90*220cm, me vlerë 2,800€ (35copë*80€=2,800€);

Pozicioni nr. 19. Furnizim dhe montim i derës për dalje emergjente me hapje nga hapësira, me vlerë 150€;

Pozicioni nr. 22. Përpunimi i dyshemesë nga parketi dhe sipas nevojës të ketë ndërhyrje nëpër vende të caktuara me qëllim përmirësimin e parketit, në vlerë 990€;

Ngrohja-Ftohja, sistemi VRF-VRV

Pozicioni nr. 3. Mbrojtëse për borë që vendosen mbi VRF nga llamarina e zinguar, në vlerë 180€;

Pozicioni nr. 4. Ventilatorë konvektor kasetore VRF, tërheqje të ajrit në mes dhe prurja në të katër anët e maskës së ventilator konvektorit, për montim në lartësi maksimale për ngrohje deri në 3.5m, me maskë, pompë për kondenzator, me mundësi të lidhjes në BMS, me fuqi termike në ftohje 7.10KW, fuqi termike në ngrohje 8,00KW, në vlerë 1700€;

Pozicioni nr. 6. Ventilatorë konvektor kasetore VRF, tërheqje të ajrit në mes dhe prurja në të katër anët e maskës së ventilator konvektorit, për montim në lartësi maksimale për ngrohje deri në 3.5m, me maskë, pompë për kondenzator, me mundësi të lidhjes në BMS, me fuqi termike në ftohje 3,60KW, fuqi termike në ngrohje 4,00KW, në vlerë 21,700€ (31cop*700€=21,700€);

Si përfundim, vlera e pozicioneve të identifikuara, të cilat janë paguar por nuk janë kryer ishte 28,360€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së përgjegjësisë për punën e kryer nga mbikëqyrësi i projektit, dhe si pasojë e neglizhencës së menaxhmentit për të mbikëqyrur projektin e financuar nga MIN.

Rreziku

Mungesa e zyrtarit mbikëqyrës nga MIN dhe në anën tjetër mos raportimi nga komuna, rrezikon realizimin e projektit sipas cilësisë së duhur dhe mund të jetë faktor i mos realizimit të projektit deri në këtë fazë. Më tej, nënshkrimi i raporteve nga menaxheri kontratës së komunës, para se punimet e kontraktuara të jenë kryer, rritë rrezikun e dëmtimit të buxhetit të ministrisë si dhe mos përfitimin e vlerës për para.

Rekomandimi A11 Ministri duhet të ndërmerr masa për caktimin e zyrtarit mbikëqyrës të projektit "Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë", i cili në bashkëpunim me komunën të siguroj se projekti realizohet në afat sa më të shpejtë në mënyrë që kjo qendër të filloj funksionimin e saj. Po ashtu, të siguroj se pozicionet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën, në të kundërtën, për punët e pa përfunduara të kërkoj kthimin e mjeteve në buxhetin e ministrisë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve të ministrisë, pasuritë kapitale ishin shpalosur në vlerë 221,592€, ndërsa ato jokapitale nuk ishin shpalosur fare. Çështjet lidhur me vlerën e shpalosur të pasurive në PFV, i kemi trajtuar tek kapitulli i Opinionit të Auditimit - Theksimi i Çështjes.

Çështja A12 - Mos inventarizimi i pasurisë së MIN

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 18, kërkon që organizatat buxhetore të inventarizojnë së paku një herë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të saj. Raporti i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

MIN, nuk kishte bërë inventarizimin e pasurisë, pasi Zyrtaari Kryesor Administrativ nuk kishte caktuar komision për kryerjen e këtij procesi. Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës në kryerjen e këtij procesi.

Reziku Mos kryerja e procesit të inventarizimit, nuk ofron sigurinë për ekzistencën fizike të pasurive të blera dhe pamundëson paraqitjen e saktë të informatave lidhur me pasuritë në PFV dhe shpalosjen e tyre në mënyrë të drejtë. Kjo gjithashtu ka efekt në menaxhimin dhe kontrollin e duhur ndaj pasurive të ministrisë.

Rekomandimi A12 Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare në OB. Procesit i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV 2019 të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në pasqyra.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 197,499€. Prej tyre, 188,506€ janë për subvencione dhe transfere, ndërsa 8,993€ për mallra dhe shërbime, si dhe komunalit. Këto obligime janë bartur për tu paguar në vitin 2019 pasi që faturat për mallra e shërbime dhe komunalit janë pranuar me vonesë, ndërsa tek subvencionet dhe transferet, për shkak të gabimeve teknike dhe vonesave gjatë regjistrimit në sistemin e SIMFK-së.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MIN, funksionimin e saj si ministri e ka filluar në tetor të vitit 2017, me ç'rast ka qenë i formuar vetëm stafi nga kabineti i ministrit. Në mungesë të stafit operativ, kjo ministri ka nënshkruar marrëveshje me ministrinë tjetra si MPJ, MZHE dhe MIE për mbështetje në kryerjen e shërbimeve financiare/administrative. Gjatë kësaj periudhe, ishte përballur me sfida lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare të saj, për shkak të mungesës së stafit.

MIN ka të miratuar rregulloren 23/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe organogramin në të cilin përshkruhen linjat e raportimit. Deri në përfundim të vitit 2018, MIN nuk ka arritur të plotësoj shumicën e pozitive udhëheqëse. Në muajin dhjetor ishte plotësuar vetëm një pozitë e udhëheqësit të departamentit (Departamenti i Ndërmarrësisë). Si rezultat i mos plotësimit të pozitive menaxheriale, nuk kanë funksionuar as linjat e raportimit/llogaridhënies, megjithatë zyrtarë të caktuar kanë raportuar përmes raporteve operative tek ZKA.

Prioritetet strategjike të ministrisë janë vendosur në Programin e Qeverisë 2017-2021. Ministria kishte përgatitur planin e punës për vitin 2018 krahas objektivave të saj. Ministria, nuk kishte arritur të përgatis planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, siç kërkohet në Rregulloren MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Vështruar sistemin e përgjithshëm të qeverisjes, dobësitë kryesore të ministrisë në veçanti janë vërejtur në planifikimin, ndarjen dhe monitorimin e subvencioneve. Kontrollet në këtë fushë janë jo efektive, dhe parregullsitë e identifikuar më lartë, dëmtojnë kredibilitetin dhe rregullsinë e tërë procesit në shpenzimin e subvencioneve.

Duke i vlerësuar shpenzimet e buxhetit në kategoritë tjetra, gjithashtu nuk mund të thuhet se është arritur performancë e kënaqshme, sidomos në fushën e investimeve kapitale, ku ishin planifikuar

realizimi i pesë projekteve. Së paku, tri Qendra Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ishin planifikuar të funksionalizohen për vitin 2018, megjithatë nuk kishte arritur të funksionalizohet asnjë prej tyre. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë me mos arritjen e objektivave prioritare të ministrisë.

Zyrtari Kryesor Administrativ, nuk kishte arritur që të dorëzoj në kohë në Ministrinë e Financave, pyetësorin e vetëvlerësimit. MIN, gjithashtu nuk kishte hartuar listën e rreziqeve brenda organizatës.

Njësia e auditimit të brendshëm ende nuk është e formuar dhe mungesa e saj përbën një mangësi në fushën e qeverisjes së mirë dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MIN, nuk e ka formuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB). Megjithatë, MIN kishte marr veprime duke iu drejtuar NJQHAB /MF, me kërkesën për mbështetje në fushën e auditimit të brendshëm për vitin 2018 nga NJQH apo përmes lidhjes së ndonjë marrëveshje mirëkuptimi me ndonjë institucion tjetër. Sa i përket vitit 2018, nuk kishte marrë përgjigje nga Ministria e Financave, përkatësisht departamenti i auditimit të brendshëm, lidhur me ofrimin e shërbimit për kryerjen e auditimit të brendshëm në ministri, dhe as nga ndonjë organizatë tjetër.

Çështja A13 - Mos themelimi i NJAB

Gjetja Bazuar Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, neni 3, përcakton që menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik, themelon NJAB-në me plotësimin e ndonjërit prej tri kriterëve: buxheti vjetor mbi mbi 1 milion euro; mbi 50 të punësuar me orar të plotë dhe në raste të veçanta për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë dhe me pëlqimin e institucioneve përgjegjëse.

MIN, megjithëse plotësonte kriterin e parë, duke qenë se buxheti vjetor për vitin 2018 ishte mbi 9 milion euro, nuk kishte arritur të themeloj NJAB.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ministria nuk kishte shpallur konkurs të rregullt për plotësimin e pozitës së auditorit të brendshëm.

Rreziku Mungesa e auditorit të brendshëm, ndikon në mos identifikimin e dobësive të mundshme dhe mos ofrimin e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi A13 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen përmes themelimit të NJAB brenda ministrisë apo nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë e duhur. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Çështja A14 - Dobësitë në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Si pasojë e mos funksionalizimit të strukturës organizative, duke qenë ministri rishtazi e themeluar, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar si duhet dhe mungesa e llogaridhënies ka ndikuar në mos aplikimin e përgjigjeve efektive dhe me kohë ndaj mangësive të identifikuara, sikurse menaxhimi jo i mirë i avanceve, mangësitë në procesin e ndarjes së subvencioneve dhe mbikëqyrjes së projekteve kapitale. Mos familjarizimi me legjislacionin në fuqi nga zyrtarët financiar kishte bërë që të ketë mangësi në menaxhimin e pasurive, duke rezultuar me theksim të çështjes në raportin e auditimit.

Ministria, nuk posedon regjistër të rreziqeve të hartuar sipas kërkesave të MFK-së, për t'i identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve dhe marrjen e masave për menaxhimin e tyre.

Gjetja Mekanizmi i dobët i llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë jo të mirë, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë, duke rritur rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi A14 Ministri, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet dhe planin e prokurimit, në mënyrë që të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, ministria duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

MIN, nuk është audituar më parë, andaj nuk ka analizë për progresin e rekomandimeve paraprake.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit 2018

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
A1	PFV	<p>Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektin e Qendrës Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, janë regjistruar në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia.</p> <p>Ministri, duhet të siguroj se janë marrë veprime të menjëhershme për sigurimin e qasjes në e-pasuri dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për pasuri, në mënyrë që të gjitha pasuritë jokapitale të ministrisë regjistrohen dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe si të tilla të prezantohen drejtë në PFV.</p>
A2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet nuk kanë arritur të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.
A3	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për plotësimin e pozitave të lira me staf të rregullt dhe jo përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa këto të fundit të aplikohen vetëm për punë/shërbime të veçanta.
A4	Mallrat dhe shërbimet	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrole efektive tek menaxhimi i avanceve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që zyrtarët të jenë përgjegjës për arsyetimin e mjeteve me kohë dhe kthimi i mjeteve të pashpenzuara në llogari të bëhet brenda afatit ligjor.
A5	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se shfrytëzimi i avancit për udhëtime zyrtare për blerje të pa autorizuar, nuk do të përsëritet në asnjë rast tjetër.
A6	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të rishikoj rastin e këtyre pagesave dhe të konfirmoj nëse pagesat janë kryer për punët e kryera jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, paratë t'i kthehen buxhetit të ministrisë.

A7	Subvencio net dhe transferet	Ministri duhet të rritë masat e përgjegjesisë ndaj komisionit të vlerësimit të OJQ-ve, për të siguruar se vlerësimi i aplikacioneve bëhet me përgjegjësi dhe objektivizëm sipas kriterëve të përcaktuara dhe kërkesave tjera ligjore.
A8	Subvencio net dhe transferet	Ministri, si edhe në rekomandimin më lart, duhet të vendos kontrolle rigorozë në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për financim të bizneseve Start Up, në mënyrë që përzgjedhja e përfituesve bëhet bazuar në objektivat e thirrjes për financim, në përputhje me udhëzimin administrativ përkatës të ministrisë.
A9	Subvencio net dhe transferet	Ministri, duhet të merr masa të menjëhershme dhe të ndërprej praktikën e tilla, duke vendosur mekanizma efektiv të mbikëqyrjes ndaj procesit të vlerësimit për mbështetje financiare ndaj Start Up-ve dhe të siguroj se komisionet e vlerësimit kryejnë punën me përgjegjësi të lartë. Në rastet ku financimi ka qenë shpenzim i papranueshëm, sikurse blerja e automjetit komercial, mjetet e përfituara të kthehen në buxhetin e ministrisë.
A10	Subvencio net dhe transferet	Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Start Up-et, për sigurimin e dëshmive të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.
A11	Investimet Kapitale	Ministri, të ndërmerr masa për caktimin e zyrtarit mbikëqyrës të projektit "Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë", i cili në bashkëpunim me komunën të siguroj se projekti realizohet në afat sa më të shpejtë në mënyrë që kjo qendër fillon funksionimin e saj. Po ashtu, të siguroj se pozicionet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën, në të kundërtën, për punët e pa përfunduara të kërkoj kthimin e mjeteve në buxhetin e ministrisë.
A12	Pasuritë kapitale dhe jokatitale	Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare në OB. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV 2019 të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në pasqyra.
A13	Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen përmes themelimit të NjAB brenda ministrisë apo nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore.
A14	Raportimi menaxherial,	Ministri, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet dhe plani i prokurimit, të jenë subjekt i raporteve

	llogaridhë nia dhe menaxhim i i rrezikut	dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, ministria duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.
--	---	--

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Hajriz Koca 

Sekretar i Përgjithshëm - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë,

Data: 14 Qershor 2019, Prishtinë.